

8827 845 13.11.81

MARREVESHJE

NDERMJET

QEVERISE SE REPUBLIKES SE SHQIPERISE DHE QEVERISE SE REPUBLIKES SE TURQISE

PER TRANSPORTIN RRUGOR NDERKOMBETAR

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë, këtu të quajtura Pale Kontraktuese me qëllim promovimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e transportit rrugor, ndërmjet këtyre dy vendeve dhe tranzit nepermjet territoreve të tyre, të frymëzuar nga parimi i liberalizimit persa i perket transportit rrugor, të bazuar në parimet e reciprocitetit dhe interesit të përbashkët kanë rënë dakord si më poshtë :

Neni 1

Qëllimi i zbatimit

Dispozitat e kësaj Marreveshjeje zbatohen në :

1. Transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave ndërmjet dy Paleve Kontraktuese në tranzitin e dy territoreve respektive.
2. Udhëtimin e mjeteve pa ngarkesë në lidhje me transportin e sipërpermendur.

Neni 2

Perkufizime

Per qëllimet e kësaj Marreveshjeje :

1. Termi "Transportues" nënkupton një person fizik ose ligjor të vendosur në secilën prej Paleve Kontraktuese që ka të drejtën të kryejë transportin rrugor të udhëtarëve ose mallrave, në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi në vendin e tij.

2. Termi "Mjet" nenkupton

a. per transportin e mallrave : nje mjet te motorizuar ose nje kombinim mjetesh nga te cilat te pakten mjeti i motorizuar eshte regjistruar ne çdonjeren nga PK dhe qe eshte perdorur dhe pajisur vetem per transportin e mallrave. b. per transportin e udhetareve: çdo mjet te fuqishem te ngare, te regjistruar ne territorin e nje PK, i cili si pasoje e ndertimit ose pajisjeve te saj eshte e pershtatshme per 9 persona ulur perfshire shoferin.

3. Termi " tranzit " nenkupton transportin e mallrave dhe udhetareve nga nje transportues i regjistruar ne nje PK neper territorin e PK tjetër.

Neni 3

Transporti i udhetareve

Me qellim transportin e udhetareve:

- " Sherbimi i rregullt " nenkupton sherbimin e transportimit te udhetareve pergjate nje rruge te caktuar sipas tarifave dhe orareve te paracaktuara, ndermjet dy Paleve Kontraktuese ose ne tranzit neper territoret e tyre.

- " Sherbimi vajtje -ardhje " nenkupton nje sherbim, i cili me anen e udhetimeve te zakonshme vajtje dhe kthim kryen transportin e grupeve te udhetareve te formuara qe me pare, respektivisht nga nje vend i vetem nisjeje ne nje destinacion te vetem. Çdo grup i perbere nga udhetaret qe bene nje udhetim vajtjeje do te kthehet ne vendin e nisjes ne nje udhetim te mevonshem.

- Ne sherbimet vajtje-ardhje asnje udhetar nuk mund te merret ose te zbrtitet gjate udhetimit.

- Udhetimi i pare i kthimit dhe i fundit i nisjes ne nje seri sherbimesh vajtje-ardhje, jane bosh.

Dispozitat lidhur me operacionet e sherbimeve te rregullta dhe vajtje-ardhje do te vendosen nga Komisioni i Perbashket i cili eshte krijuar ne perputhje me nenin 11 te kesaj Marreveshjeje ne baze te marreveshjes se perbashket te autoriteteve qe nenshkruajne kete Marreveshje, te bazuar ne perfundimet e pranuar.

- Termi " Tranzit " nenkupton transportin e udhetareve duke nisur nga territori i PK ku eshte regjistruar mjeti, duke pershkuar territorin e vendit tjetër dhe anasjelltas me kusht qe te mos merret ose zbritet asnje udhetar gjate udhetimit.

Sherbimet e rastit jane:

a. Udhëtimet me dyer të mbyllura, që quhen shërbimet në të cilat i njëjti mjet përdoret për të transportuar të njëjtin grup udhëtarësh gjatë gjithë udhëtimit dhe për të kthyer ata perseri në vendin e nisjes, vendin në të cilin është regjistruar mjeti.

b. Shërbimet në të cilat udhëtimi i vajtjes është bërë plot dhe udhëtimi i kthimit bosh.

c. Shërbimet në të cilat udhëtimi i vajtjes është bërë bosh dhe i kthimit i ngarkuar me udhëtarët e marre në të njëjten pikë të vendit ku nuk është regjistruar mjeti, me kusht që udhëtarët :

1. të përbejnë një grup sipas një kontrate transporti, të përfunduar para arritjes së tyre në territorin e PK nga ku janë marre.

2. janë të ftuar në territorin e vendit të themelimit të transportuesit dhe kosto e transportit mbulohet nga personi që ka bërë ftesën.

Neni 4

Hyrja në treg

1. Shërbimet e rastit të përmendura në nenin 3 do të përjashtohen nga leja e transportit për territorin e Pales Kontraktuese ku mjeti nuk është i regjistruar.

2. Shërbimet e rastit duhet të shoqërohen nga një dokument kontrolli.

3. Dokumenti i kontrollit do të përfshijë një formular udhëtimi.

4. Formulari i udhëtimit duhet të përmbajë të pakten informacionin e mëposhtem:

a. tipin e shërbimit

b. itinerarin kryesor

c. transportuesit e përfshirë

d. një listë të plote të udhëtarëve.

5. Shërbimet e rregullta në transportin tranzit behen me autorizimin ose lejen e leshuar nga vendi në tranzit pasi është bërë një aplikim.

6. Në transportin tranzit nuk mund të merren ose zbriten udhëtarë gjatë udhëtimit, veçse nëse Komisioni i Përbashkët i vendosur në nenin 11 vendos ndryshe.

Neni 5

1. Sherbimet e rregullta dhe vajtje-ardhje jane subjekt autorizimesh (lejesh).
2. Autorizimet do te jepen nen emrin e sipermarresit transportues.
Ky i fundit nuk mund t'ia transferoje kete paleve te treta. Sidoqofte, transportuesi qe ka marre autorizimin mund ti plotesoje sherbimet e tij nepermjet nje kompanie te vecante.
3. Periudha e vlefshmerise se nje autorizimi nuk duhet te kaloje tre vjet per sherbimet e rregullta dhe 1 vit per sherbimet vajtje-ardhje.
4. Autorizimi do te specifikojë te meposhtemet :
 - a. tipin e sherbimit
 - b. rrugen e sherbimit, pikat e nisjes dhe mberitjes si dhe pikat kufitare.
 - c. periudhen e vlefshmerise se autorizimit
 - d. ndalesat dhe oraret per sherbimet e rregullta.
5. Aplikimi per autorizim do te shqyrtohet nga autoritetet kompetente te Pales Kontraktuese ku eshte regjistruar mjeti. Ne rast se aplikimi pranohet, autoriteti me siper do t'ia komunikojë kete autoritetit kompetent te Pales Kontraktuese tjeter. Ne rast se ky i fundit bie dakord, atehere çdo autoritet do te jape autorizimin ne pjesen e itinerarit qe kryhet ne territorin e tij.
6. Aplikimi ne dy kopje duhet te permbaje te dhena lidhur me rregullat kombetare si dhe linjen e pershkuar stopat e autobusit te shenuara qarte, kilometrat, oraret dhe tarifat.
7. Gjate udhetimit nje kopje e autorizimit e dhene nga autoriteti zyrtar qe i leshon, ose origjinali, duhet te jene ne mjet.
8. Autorizimet duhet te behen konform modelit qe do te pergatitet nga Komisioni i Perbashket i permendur ne Nenin 11 te kesaj Marreveshjeje.

Neni 6

Ne sherbimet e rastit, mjetet qe kalojne tranzit ne territorin e nje Pale Kontraktuese dhe jane regjistruar ne Palen tjeter Kontraktuese , jane te perjashtuara nga çdo autorizim.

Neni 7

Nje sherbim i rregullt lejohet te kryhet vetem kur eshte miratuar dhe autoritetet pergjegjese te te dy Paleve Kontraktuese kane kembyer licensat e vecanta me permbajtjen e nevojshme.

Neni 8

Transporti i mallrave :

Transportuesit e vendosur ne territorin e nje Pale Kontraktuese, lejohet te kryejne transport rrugor te mallrave ndermjet dy vendeve dhe transport tranzit ne vendet e tyre, pa qene subjekt autorizimi.

Transporti i mallrave per dhe nga vendet e treta do te jene subjekt i autorizimit.

Neni 9

Forma dhe permbajtja e lejeve te vendeve te treta te permendura ne nenin 8 percaktohen nga Komisioni i Perbashket i permendur ne nenin 11 te kesaj Marreveshjeje.

Lejet e permendura do te kembehen nga Pala Kontraktuese cdo vit nepermjet kanaleve diplomatike dhe ne perputhje me procedurat e vendosura nga Komisioni i Perbashket i permendur ne nenin 11.

Neni 10

Lejet nuk jane te nevojshme ne rastet e meposhteme:

1. transporti i objekteve nga dhe per ne aeroportet publike si pasoje e rastesise ose aksidenteve te tjera ne aeroplan ose nese aeroplani duhet te ulet ne toke per shkak te ndryshimit te kursit ose emergjencave dhe ne rast se fluturimi anulohet .
2. Transporti funeral
3. Transport i sendeve personale ne kontekstin e zhvendosjes se pajisjeve shtepiake me mjete te vecanta.
4. Transporti i postes.
5. Transporti i mallrave per panair dhe ekspozita.
6. Transporti i aksesoreve dhe mallrave te tjera per ngjarje teatrale, muzikore etj. shfaqje cirku dhe filmi dhe paraqitja ne radio ose televizor.
7. Transporti i kafsheve te ngordhura vetem ne rast se eshte punimi industrial i lendes se pare.

8. Transporti i luleve dhe bimeve dekorative.
 9. Transporti i kafsheve me perjashtim te kafsheve te therura nga mjete te pajisura per kete qellim.
 10. Transporti i medikamenteve si ndihma ne rast fatkeqesish te shkaktuara nga dukuri fizike.
 11. Transporti i ngarkeses per qellime edukative ose promocionale.
 12. Transporti i mjeteve te demtuara ose me difekt.
 13. Sipas kushteve te tjera te vendosura nga komisioni i perbashket.
- Ne lidhje me operacionet e transportit te permendura ne kete nen, shoferet duhet te mbajne gjithë dokumentet qe tregojne se perfshihen ne nje nga rastet me siper.

Neni 11

Dispozita te pergjithshme

Ne menyre qe te rregullohen te gjitha ceshtjet lidhur me implementimin dhe aplikimin e kesaj Marreveshjeje, do te themelohet nje Komision i Perbashket.

Komisioni i Perbashket do te perbehet nga perfaqesuesit e Qeverive te te dy Paleve Kontraktuese qe mund te ftojne perfaqesues te industrise te transportit rrugor ne takime. Komisioni i Perbashket do te mblidhet te pakten nje here ne vit.

Axhenda e Takimit do te paraqitet te pakten 2 jave perpara nga Palet Kontraktuese pritesë ose qe e kerkon takimin.

Çdo takim do te perfundoje me miratimin e nje Protokolli te firmosur nga Kryetaret e Delegacioneve te te dy Paleve Kontraktuese.

Neni 12

Palet Kontraktuese njoftojne njeri-tjetrin qe autoritetet kompetente qe do te zgjidhin ceshtjet lidhur me implementimin e dispozitave te kesaj Marreveshjeje do te jene:

- Per Republiken e Shqiperise
Ministria e Transportit
Drejtoria e Transportit Rrugor
- Per Republiken e Turqise
Ministria e Transportit
Drejtoria e Pergjithshme e Transportit Tokesor

Neni 13

Palet Kontraktuese nuk do të marrin asnjë takse si p.sh. eksport-importi ose taksa zyrtare (përfshirë taksat doganore) për mjetet e regjistruara në Palet Kontraktuese me përjashtim të :

- a. taksat për përdorimin e rrjetit të infrastrukurës rrugore (taksat për rrugët dhe urat).
- b. taksat e marra nga mirëmbajtja dhe mbrojtja e rrugës për të paguar shpenzimet administrative të rrugës dhe transportit.
- c. Taksat e marra në rast se pesha, përmasat ose ngarkesa e një mjeti kalon kufijtë e përcaktuara në legjislacionin kompetent të Paleve Kontraktuese.

Transporti i autorizuar në tranzit nëpër territoret e Paleve Kontraktuese mund të përjashtohet nga taksat në bazë reciproke siç është parashikuar në paragrafin (b) më sipër.

Neni 14

Transportuesit dhe ekuipazhet e mjeteve të tyre të një Pale Kontraktuese do të veprojnë në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi në territorin e vendit tjetër.

Çështje të tjera lidhur me transportin që nuk përfshihen në këtë Marrëveshje, do të jenë subjekt i ligjeve, rregullimeve dhe rregullave të Paleve Kontraktuese.

Neni 15

Siguracioni

Mjetet e Paleve Kontraktuese që kryejnë transport ndërkombëtar duhet të jenë të siguruar si në vendet tranzit ashtu dhe në vendin e mbërritjes.

Neni 16

Kabotazhi

Mjetet e regjistruara në qdonjerin nga vendet e Paleve Kontraktuese nuk do të transportojnë mallra ose udhëtarë ndërmjet dy pikave brenda territorit të Paleve tjetër Kontraktuese.

Neni 17

Doganat dhe Kontrolli Shendetesor

Dispozitat e Konventave Nderkombetare te miratuara nga Palet Kontraktuese zbatohen ne pikat kufitare te doganave dhe kontrollit shendetesor.

Kontrolli ne fjale behet me prioritet transportin e pacienteve, kafsheve dhe mallrave qe prishen shpejt, ne se eshte e mundur.

Neni 18

Kontrolli teknik i mjeteve

Nje mjet i nje Pale Kontraktuese qe kryen transport bilateral dhe tranzit ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese duhet te pajiset nga nje autoritet shteteror me çertifikate te vlefshme per sigurine rrugore.

Autoritetet kompetente te Paleve Kontraktuese ne territorin e te cilave kryhet operacioni i transportit mund te kerkoje kryerjen e kontrollit teknik ne mjetet e Pales tjeter Kontraktuese.

Nje mjet i njerres Pale Kontraktuese qe kryen transport bilateral ose tranzit ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese dhe qe transporton mallra te rrezikshme duhet te kete te gjithë dokumentet e parashikuara nga Konventa ADR.

Neni 19

“ Marreveshja ndermjet Qeverise se Republikes Popullore Socialiste te Shqiperise dhe Qeverise se Republikes se Turqise per transportin rrugor nderkombetar”, nenshkruar ne 2 gusht 1988, do te perfundoje me hyrjen ne fuqi te kesaj Marreveshje.

Neni 20

Marreveshja do te hyje ne fuqi ne daten e kembimit te letrave qe deshmojne plotesimin e kerkesave respektive konstitucionale te Paleve Kontraktuese. Do te mbetet ne fuqi per nje vit. Pas kesaj, mund te zgjatet automatikisht per nje periudhe tjeter nje vjeçare, ne se asnje nga Palet nuk lajmeron tjetren 6 muaj perpara dates se perfundimit, per qellimin e saj per perfundimin e Marreveshjes .

Bere ne 24 SHKUR T. 2000, ne Tirane dy kopje origjinale ne shqip, turqisht dhe anglisht, cdo tekst eshte i barazylershem. Ne rast diskutimi vlen versioni ne anglisht.

Ne deshmi te nenshkruarit qe jane te autorizuar per kete, kane nenshkruar kete Marreveshje.

Per Qeverine e Republikes se

Shqiperise

Astrit AVDULAJ

Drejtore Drejtorie

ne Ministrine e Transportit



Per Qeverine e Republikes se

Turqise

Ahmet BALCI

Zevendes Nensekretar

i Ministrise se Transportit

